

Pershkrim i objekteve kulturore:

➤ **Xhamia e re e Peshkopise**

Ne veren e vitit 2006 nisen punimet per ndertimin e xhamise se re me dy minare te Peshkopise dhe me 1 Shtator 2009 u be inagurimi i saje.

Xhamia u ndertua me kontributin e Abdyl Gani, nga Daka ,Katar.

Xhamia u projektua nga inxhinieret Zabit Muda dhe Agim Islami. Trualli prej 500 m² u dhurua nga Ilir Shehu.



Xhamia Peshkopi, Rrethi Diber

2.Xhamia e Allajbegise



Xhamia e Allajbegise

Ndodhet ne Lindje te fshatit Burim, ne te djathte te rruges Tirane-Peshkopi. Xhamia eshte ndertuar ne vitin 1585.

Ka forme kubike me kupole, sallën e lutjeve me permasa 6.4m me 6.27m. Minarja ka bazament shumfaqesh. Xhamia ka 10dritare me korniza guri.

Brenda xhamise ka salla studimi. Teknika e ndertimit eshte artizanale, kultura shqiptare. EShte shpallur monument kulture ne vitin 1970.

Kisha e Shperfytyrimit:



Kjo Kisha ndodhet ne Fshatin Herbel, rreth 1.5 km ne lindje te rruges Peshkopi-Tirane. Eshte ndertuar para pushtimit turk, me nje teknike te thjeshte, Pranaus-Nauso-Absieda tre faqesh. Materiali i ndertimit eshte gur dhe llaç gelqereje.



Kisha e Çveti Spas(Shen Sofia)

Kjo kisha ndodhet ne fshatin Kerçishte te komunes Maqellare. Kisha eshte ndertuar nga viti 1270. Ne mure ruhen afreske me permasa 7x3.2m, por qe jane te demtuara. Muret jane te ndertuara me gure te lidhur me llaç gelqereje.

Çatia eshte mbuluar me rasa guri. Ne vitin 2007 eshte shpallur monument kulture.

Ujrat termominerale-Llixhat e Peshkopise



Kompleksi balnear kurativ i ujrave termale te Peshkopise shtrihet rreth dy kilometra ne lindje te qytetit te Peshkopise, ne te djathte te rrjedhes se perroit te Belloves, poshte vargmalit te Deshatit.

Ky kompleks ka 44 kabina individuale disa kabina teterapeutike, te cilat perfshijne trajtime te baltes sulfurore, fizioterapise dhe i aerosal terapise.

Gjithashtu ka dy dhoma reaminacioni per trajtimin e rasteve urgjente.Perdorimi i ujrave kurative ofron sherbime terapeutike lidhur me trajtimin e trupit dhe mendjes.

➤ **Shpellat:**

Shpellat e shumta te dibres, jane nje risi trjeter e kesaj treve, te shfrytezuar qe nga njeriu primitiv deri ne mesjeten e hershme. Ne shpellat me te rendesishme

mund te permendim Shpellen e Skenderbeut ne Reç, Spellen e Belloves, Shpellen e Boroves, E Nazirit ne Mat, Shpella e Radit(ku jane gjetur objekte prehistorike), Shpella e Ostrenit te Madh, Shpella e Shokranit ne komunen Muhurr, Shpella e pellumbit afer fshatit Kastriot, Shpella e Gjurasit ne komunen e Shupenzes etj.

Shpella e Belloves eshte nje shpelle karakteristike e formuar ne gipset e permiantit te sipërm. Ndodhet ne lartesi 1400m mbi nivelin e detitne lindje te qytetit te Peshkopise ne afersi te fshatit Bellove.

➤ **Monumente natyre:**

Ne Diber ekzistojne shume monumente Natyre, nder te cilet mund te permendim Liqenet e Kacnise, ne komunen Selishte, Ujvara e pocestit, Boreviku i Bugjunecit, Liqeni i Zi i Radomires dhe Parku Kombetar i Lures.

Liqenet e Kacnise, jane akullnajore, ndodhet ne shpatin Lindor te malit Balgjajt, ne lartesine , mbi 1700m, dhe kane gjatesi mesatare 50-100m e gjeresi 20-35m dhe formojne nje ekosistem interesant te liqeneve Alpine. Uji I tyre eshte I paster si kristali dhe shume i fothte, I cili ngrin ne siperfaqe gjate dimrit.



Liqeni Balgjajt, Liqenet e Kacnise

Ujvara e Pocestit:



Ujvara e Pocestit, ndodhet ne lartesine 1500m, ne shpatin lindor te malit te Deshatit, ne afresi te fshatit Maqellare. Kjo ujvare e bukur dhe mahnitese eshte me lartesi **13m** dhe formohet nga uji qe del nga nje e care e madhe ne shkemb in e thepisur gelqeror, duke formuar nje burim te madh karakteristik ku zhurma e te cilit degjohet ne nje largesi shume te madhe.

Liqeni i zi eshte gjithashtu nje liqen akullnajor dhe ndodhet ne lartesine mbi 2200m ne pjesen veriore-perendimore te fshatit Radomire.

Liqeni I zi ka nje Sip. Pre **0.8ha**, me uje te paster dhe te ftohte dhe rrethohet nga nje pyll shume i bukur.

Parku Kombetar i Lures:

Parku Kombetar i Lures ndodhet rreth 55km larg nga qyteti I Peshkopise. Flora dhe Fauna jane shume te pasura. Parku ngirhet ne lartesine 1375 -1919m mbi nivelin e detit dhe shtrihet ne faqen lindore te masivit

Kurora e Lures:

Lura ka nje siperfaqe 1280ha, nga e cila 1100 ha pyje, 50 ha livadhe dhe 30ha pasqyra e ujit te liqeneve.

Pikat specifike qe duhet te vizitohen brenda parkut perfshijne Fushen e pelave , liqenet qe quhen “Shtate Syte e Kalter”, me qerpikete te gjelbert”, te Lures.

➤ *Fusha e pelave*

Shtrihet ne lartesine mbi detare **1580m** dhe ndodhet ne pjesen jugore te parkut.

Ajo ka nje livadh alpin me nje siperfaqe prej **18 ha**, me nje bukuri te vecante qe i ka zene vendin nje liqeni akullnajor tashme te thare.

Livadhi rrethohet nga nje Flore e larmishme e cila perbehet nga lule shumengjyreshe dhe drure halor shekullor.

Parku Kombetar ka 12 liqene ne total, Shtate liqene njihen si”**Shtatsykalter me qerpik te gjelbert,**” sepse kane nje bukuri mahnitese dhe kane uje gjate gjithe vitit.

Liqenet kryesore te parkut jane: **Liqeni i Luleve** –lartesia mbi detare 1585m me nje siperfaqe, 1.44ha, **Liqeni i Kallabas**-lartesia 1575m, siperfaqe3.6 ha dhe thellesi 12m, **Liqeni i Zi**, lartesia 1620m me siperfaqe 2.5 ha dhe thellesi 10m.

Liqeni i Rasave- Lartesia **1600m** me siperfaqe 0.4ha dhe thellesi 2.5m

Liqeni i Hotit-lartesia **1500m**, me siperfaqe 1.84ha me thellesi 3m.

Liqeni i Kalates-lartesia **1500m** me siperfaqe, 3.6ha dhe thellesia 12m.

Liqenet jane te pasura me nje bote te gjalle, te larmishme dhe formojne nje sistem ekologjik tipik te liqeneve alpine me bukuri te rralle.

➤ **ALPINIZEM:**

Dibra eshte nje vend kryesishte kodrinor –malor, ku pervec Flores dhe Faunes e pasurive te tjera minerale, ushtrohet edhe Alpinizmi.

Numerohen mbi 30 maja malesh me nje koeficient te theksuar veshtiresie per alpinizem, ku me te njohurat jane: Mali i Korabit, mbi 2750m, mali me i larte ne Shqiperi dhe Maqedoni, afer Radomires ne komunen Kala e Dodes;

Maja e Velivarit-2374m afer fshatit Ilnice ne komunen Melan: Mali i kerçinit-2345m afer Kerçishtit ne komunen Maqellare.

Mali i Dejes-2246m, afer Lukanit, ne komunen Selishte

Kurore e Lures-2121m, afer Borjes ne komunen lure.

Maja e Sorokolit-2178m afer Ploshtanit ne Komunen Kala e Dodes.

Maja e Tomisit dhe Mali i Raducit-2132m dhe 2084m, perkatesishte te dyja afer Steblevesne komunen Studen.

Maja e Runjes 2047 m, afer Lukanit ne Komunen Selishte.

Maja e Dhokosit dhe Maja e Kreshtes-2020mdhe 2101m, perkatesishte te dyja ne Bulqize.

Shume prej ketyre Maleve jane me te arritshme nga fshatrat prane tyre.

Per te pare nga afer malet dhe per te shuar kureshtjen per to mund te marrim si udherrefyes barinjte e ketyre zonave pasi e njohin mire terrenin dhe rrugen drejt tyre.

STANET NE DIBER.

Stane ne Diber kane qene dhe vazhdojne te mbeten “ industria” fushore e prodhimeve blegtorale. Stanet me te permendura si per kullotjen e bagetive ashtu edhe per cilesine e bulmetrave jane ato te grames, Bjeshket e Korabit, Bjeshket e greves,Popinares, te Kamavecit (Bulqize), Stanet e Pratit, Bufullit, Zmacit te komunes Selishte, te Titajares, Gjergjishtes, Pregja-Lure, dhe fusha e Pelave te Lures. Stanet e Ternoves dhe te Malit te Bardhe te komunes se Zerqanit. Melodite pafund te fyejve dhe kavalleve, simfonia monotone e kembanave te bagetive, aroma e kendshme e luleve te bjeshkeve, jane nje mrekulli e vertete e jetes baritore ne Bjeshket e Dibres.